"call center" dhe "contact center" ose mjete të tjera të transmetimit, ruajtjes dhe ndarjes së të  
dhënave sipas teknologjive aktuale dhe ato të ardhshme, duke përfshirë për shembull interneti,



televizioni interaktiv, telefonia fikse dhe celulare, transmetimet satelitore, pajisjet elektronike që mundësojnë shërbimet e rrejt.

b) kryerja e shërbimeve marketing dhe kërkimit të tregut , dhe nëpërmjet "call center" "dhe "contact center" ose mjeteve të tjera të transmetimit , ruajtjes dhe ndarjes së të dhënave sipas teknologjive aktuale dhe ato të ardhshme;

c) shitjen e produkteve dhe/ose shërbimeve për palët e treta, asistencën dhe trajnimin për komunikim të drejtpërdrejtë. Promovimi dhe shpërndarja e shërbimeve, për llogari të saj ose si agjenci brokerimi, të gjitha në përputhje të plotë me rregulloret aktuale në fuqi. Ai gjithashtu , për aktivitetet e sipërpërmendura mund të krijojë sisteme të filializimit tregtar.

d) krijimin e aplikacioneve dhe zgjidhjeve informatike (zakonisht të njohura si softuer) dhe implementimin e tyre, personalizimin, asistencën teknike, blerjen, transferimin dhe shfrytëzimin komercial në çdo formë, qoftë softuer në pronësi ose të blerë me licencë për përdorim; shfrytëzimin ekonomik në çdo formë të teknologjive, teksteve, modeleve, markave tregtare, patentave, licencave, produkteve, grafikëve, informatike dhe si rezultat i krijimit, gjithashtu në koncesion ose për llogari të palëve të treta, që lidhen me informatikën.

e) studimin, hartimin, zhvillimin dhe menaxhimin, si në emër të tij ashtu edhe në emër të palëve të treta, të bazave të të dhënave dhe arkivave të informacionit të strukturuar për futjen, kërkimin, përditësimin, monitorimin dhe fshirjen e të dhënave, me ndihmën , por jo ekskluzivisht, të sistemeve kompjuterike; menaxhimin e "data warehouse" dhe mjeteve për lokalizimin e të dhënave, për ti nxjerre, transformuar dhe ngarkuar, "datamining", "information retrieval" dhe në përgjithësi outsourcing të proceseve informatike, arkivimin elektronik të të dhënave, krijimin e indekseve, raporteve dhe përmbledhje të të dhënave të përpunuara.

f) organizimi, mbajtja, koordinimi i seminareve, simpoziumeve, takimeve, plane dhe kurse kolektive dhe individuale, trajnimi i stafit në fushën e informatikës (me përjashtim të ndërmjetësimit në vendodhje).

g) veprimtarinë analizimit, projektimit, zhvillimit të dokumentacionit, instalimit të sistemeve informatike ,telematik dhe rrjeteve të ekzekutimit të shërbimeve përkatëse;

h) Aktivitet publikimi (përjashto botimin të gazetave), trajnimi dhe konsulenca në përgjithësi në çështjet që lidhen me teknologjinë e informacionit, automatizimin dhe organizimin, gjithashtu në lidhje me menaxhimin e biznesit;

i) Blerja, transformimi, shitja dhe marrja me qira të pajisjeve dhe sistemeve në përgjithësi për teknologjinë e informacionit dhe automatizimin, si të prodhimit vetjak ashtu edhe të përfaqësimit;

j) Projektimin, realizim, instalimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin, me çdo teknikë, mjete dhe sistem, të impianteve dhe rrjeteve të telekomunikacionit, në pronësi të kompanisë ose të palëve të treta, qofshin fikse, të levizshme ose satelitore, për përhapjen e aktivitetit, pa kufij territorialë, të shërbimeve të komunikimit që rezultojnë gjithashtu nga evoluimi i teknologjive;

k) Ushtrimi i aktiviteteve të konsulencës informatike dhe telematike për shoqëritë, kompanitë, organet publike, studiot profesionale, duke përfshirë, në veçanti: analizën e produkteve informatike ekzistuese në tregun vendas dhe të huaj; Kontrolli i korrektësisë së këtyre produkteve përmes përdorimit të programeve të certifikimit, të dizajnuara për të verifikuar kriticitetin e tyre si në lidhje me harduerin (kompjuterin, pajisjet periferike, memorie) ashtu edhe softuerin (sisteme operative, gjuhë, shërbime, paketa aplikimesh, etj.); çdo shtesë me veçori të reja;

l) Tregtim, asistencë dhe mirëmbajtje e produkteve informues, si dhe ofrimi i shërbimeve grafike;



m) Shitblerja, shkëmbimi, importi, eksporti, koncesioni në përdorim ose me qira, shitja dhe në përgjithësi përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të të gjitha llojeve, përfshirë ato të regjistruara në regjistrat publik;

n) Blerja, si veprimtari jo kryesore, të interesave dhe pjesëmarrjes në kompani ose ndërmarrje në përgjithësi që kryejnë veprimtari që janë brenda qëllimit shoqëror ose në çdo rast të lidhur me të, plotësuese ose të ngjashme, në përputhje me kufijtë e parashikuar nga legjislacioni aktual në këtë fushë;

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme dhe ato financiare, dhe në çdo rast në një mënyrë mbizotëruese dhe jo për publikun, të konsideruara të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera, gjithmonë nëse një lëshim i tillë nuk konfiguron aktivitetin e dhënies së financimeve të ushtruar "ndaj publikut". Shoqëria mund të kryejë mbledhjen e kursimeve me anë të marrjes së fondeve me detyrimin e rimbursimit, pranë ortakeve, në përputhje me dispozitatë të komitetit ndërmintor për kredinë dhe kursimin e miratuar me vendimin n. 1058 datë 19 korrik 2005, ndryshimet dhe shtesat e tij të mëvonshme. "

Rregullat në lidhje me funksionimin e shoqërisë përmbahen në statutin, i cili, është diskutuar, miratuar dhe nënshkruar nga palët, i bashkëlidhet nën shtojcën "A".

## Neni 2

Viti i parë financiar i shoqërisë do të mbyllet në 31 Dhjetor 2014.

## Neni 3

Formojë këshillin e administrimit, deri në revokim ose dorëheqje, , pas përcaktimit të numrit të tij në tre

anëtarë, emërohen:

-**MANFREDI PAOLINO**, i lindur në Baucina më 17 gusht 1959, (kodi fiskal MNF PLN 59M17 A719R);

- **REGOLO FABIO**, lindur në Milano më 12 gusht 1964, (kodi fiskal RGL FBA 64M12 F205L)

- **BONUGLIA ANTONELLO**, e lindur në Romë më 8 mars 1966, (kodi fiskal BNG NNL 66C08 H501H);

të gjithë shtetas italianë dhe me vendbanim për detyrën pranë selinë së shoqërisë , duke caktuar si kryetar të saj **MANFREDI PAOLINO** .

## Neni 4

Kapitali aksionar është 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë / 00), nënshkruar nga aksionarët në ndarjen e mëposhtme:

- "VENTUNO GROUP S. P .A.", pjesëmarrje e aksioneve e barabartë me 55% për t'u paguar me kontribut të parave;

- "PAUL MANFEDI LIMITED", pjesëmarrje e aksioneve e barabartë me 45% për t'u paguar me kontribut të parave.

Në lidhje me pjesëmarrjet e përshkruara më sipër, shoqëria "VENTUNO GROUP S. P .A.", siç është përfaqësua më sipër, deklaron se i ka paguar shoqërisë, në të njëjtën kohë me nënshkrimin



e aktit, shumën prej 12,500,00 €. (dymbëdhjetë mijë e pesëqind / OO ), e barabartë me 25% të kontributeve në para, prej te cilave 5,625,00 € në emër të aksionerit "PAUL MANDREDI LIMITED", me anë të një ceku qarkullues të patransferueshëm të lëshuar më 25 nëntor 2013 nr. 4004452569 nga BCC Credito Cooperativo - Iccrea Banca – Agensia si Sesto San Giovanni, çek dorëzuar në duart e kryetarit të emëruar të bordit të drejtorëve dr. MANFREDI PAOLINO, i cili prezent në akt, deklaron se pranon detyrën.

#### **Neni 5**

Dr. MANFREDI PAOLINO autorizohet të pranojë dhe të prezantojë në këtë akt dhe në statutin bashkëlidhur, të gjithë modifikimet, fshirjet dhe shtesat që mund të kërkohen në momentin e regjistrimit të këtij akti në Regjistrin e Shoqërive.

\*\*\*\*

### **STATUTI**

#### **EMËRTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHËZGJATJA**

#### **Neni 1 - Emri**

Kompania quhet:

**"4U ITALIA S.R.L."**

#### **Neni 2 - Objekti**

Shoqëria ka për objekt:

- a) ofrimi i shërbimeve për konsumatorët, kompanitë dhe entet publike dhe private, duke përfshirë "call center" dhe "contact center" ose mjete të tjera të transmetimit, ruajtjes dhe ndarjes së të dhënave sipas teknologjive aktuale dhe ato të ardhshme, duke përfshirë për shembull interneti, televizioni interaktiv, telefonia fikse dhe celulare, transmetimet satelitore, pajisjet elektronike që mundësojnë shërbimet e rrjetit.
- b) kryerja e shërbimeve marketing dhe kërkimit të tregut, dhe nëpërmjet "call center", dhe "contact center" ose mjeteve të tjera të transmetimit, ruajtjes dhe ndarjes së të dhënave sipas teknologjive aktuale dhe ato të ardhshme;



c) shitjen e produkteve dhe/ose shërbimeve për palët e treta, asistencën dhe trajnimin për komunikim të drejtpërdrejtë. Promovimi dhe shpërndarja e shërbimeve, për llogari të saj ose si agjenci brokerimi, të gjitha në përputhje të plotë me rregulloret aktuale në fuqi. Ai gjithashtu, për aktivitetet e sipërpërmendura mund të krijojë sisteme të filializimit tregtar.

d) krijimin e aplikacioneve dhe zgjidhjeve informatike (zakonisht të njohura si softuer) dhe implementimin e tyre, personalizimin, asistencën teknike, blerjen, transferimin dhe shfrytëzimin komercial në çdo formë, qoftë softuer në pronësi ose të blerë me licencë për përdorim; shfrytëzimin ekonomik në çdo formë të teknologjive, teksteve, modeleve, markave tregtare, patentave, licencave, produkteve, grafikëve, informatike dhe si rezultat i krijimit, gjithashtu në koncesion ose për llogari të palëve të treta, që lidhen me informatikën.

e) studimin, hartimin, zhvillimin dhe menaxhimin, si në emër të tij ashtu edhe në emër të palëve të treta, të bazave të të dhënave dhe arkivave të informacionit të strukturuar për futjen, kërkimin, përditësimin, monitorimin dhe fshirjen e të dhënave, me ndihmën, por jo ekskluzivisht, të sistemeve kompjuterike; menaxhimin e "data warehouse" dhe mjeteve për lokalizimin e të dhënave, për ti nxjerre, transformuar dhe ngarkuar, "datamining", "information retrieval" dhe në përgjithësi outsourcing të proceseve informatike, arkivimin elektronik të të dhënave, krijimin e indekseve, raporteve dhe përmbledhje të të dhënave të përpunuara.

f) organizimi, mbajtja, koordinimi i seminareve, simpoziumeve, takimeve, plane dhe kurse kolektive dhe individuale, trajnimi i stafit në fushën e informatikës (me përjashtim të ndërmjetësimit në vendodhje).

g) veprimtarinë analizimit, projektimit, zhvillimit të dokumentacionit, instalimit të sistemeve informatike, telematik dhe rrjeteve të ekzekutimit të shërbimeve përkatëse;

h) Aktivitet publikimi (përjashto botimin të gazetave), trajnimi dhe konsulencia në përgjithësi në çështjet që lidhen me teknologjinë e informacionit, automatizimin dhe organizimin, gjithashtu në lidhje me menaxhimin e biznesit;

i) Blerja, transformimi, shitja dhe marrja me qira të pajisjeve dhe sistemeve në përgjithësi për teknologjinë e informacionit dhe automatizimin, si të prodhimit vetjak ashtu edhe të përfaqësimit;

j) Projektimin, realizim, instalimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin, me çdo teknikë, mjete dhe sistem, të impianteve dhe rrjeteve të telekomunikacionit, në pronësi të kompanisë ose të palëve të treta, qofshin fikse, të levizshme ose satelitore, për përhapjen e aktivitetit, pa kufij territorialë, të shërbimeve të komunikimit që rezultojnë gjithashtu nga evoluimi i teknologjive;

k) Ushtrimi i aktiviteteve të konsulencës informatike dhe telematike për shoqëritë, kompanitë, organet publike, studiot profesionale, duke përfshirë, në veçanti: analizën e produkteve informatike ekzistuese në tregun vendas dhe të huaj; Kontrolli i korrektësisë së këtyre produkteve përmes përdorimit të programeve të certifikimit, të dizajnuara për të verifikuar kritikitetin e tyre si në lidhje me harduerin (kompjuterin, pajisjet periferike, memorie) ashtu edhe softuerin (sisteme operative, gjuhë, shërbime, paketa aplikimesh, etj.); çdo shtesë me veçori të reja;

l) Tregtim, asistencë dhe mirëmbajtje e produkteve informues, si dhe ofrimi i shërbimeve grafike;

m) Shitblerja, shkëmbimi, importi, eksporti, koncesioni në përdorim ose me qira, shitja dhe në përgjithësi përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të të gjitha llojeve, përfshirë ato të regjistruara në regjistrat publik;

n) Blerja, si veprimtari jo kryesore, të interesave dhe pjesëmarrjes në kompani ose ndërmarrje në përgjithësi që kryejnë veprimtari që janë brenda qëllimit shoqëror ose në çdo rast të lidhur me të,



plotësuese ose te ngjashme, në përputhje me kufijtë e parashikuar nga legjislacioni aktual në këtë fushë;

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme dhe ato financiare, dhe në çdo rast në një mënyrë mbizotëruese dhe jo për publikun, të konsideruara të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fideiusioneve dhe garancive të tjera, gjithmonë nëse një lëshim i tillë nuk konfiguron aktivitetin e dhënies së financimeve e ushtruar "ndaj publikut".

Shoqëria mund të kryejë mbledhjen e kursimeve me anë të marrjes së fondeve me detyrimin e rimbursimit, pranë ortakëve, në përputhje me dispozitave të komitetit ndërmintor për kreditë dhe kursimin e miratuar me vendimin n. 1058 date 19 korrik 2005, ndryshimet dhe shtesat e tij të mëvonshme.

### **Neni 3- Selia**

Shoqëria ka selinë në Komunën e Sesto San Giovanni (MI) në adresën që rezulton nga regjistrimi i posaçëm i bërë në Regjistrin e Shoqërive.

Organi Administrativ ka kompetencë të themelojë dhe të mbyllë kudo selite dytësore pa përfaqësi të përhershme, ose të transferoje selinë shoqërisë në bashkinë më sipërpërmendur; i takon aksionarëve të vendosin për transferimin të selisë së regjistruar në një komunë të ndryshme nga ajo e përcaktuar më sipër.

### **Neni 4- Vendbanimi i aksionarëve**

Vendbanimi i aksionarëve, numri i telefaksit dhe adresa e e-mail, në të cilin janë kryer në mënyrë të vlefshme komunikimet ose njoftimet parashikuara nga kompania, janë ato që përcaktohen në aktin e themelimit ose më pas formalisht i komunikohet shoqërisë me letër rekomande me dëftesë kthimi.

### **Neni 5 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë përcaktohet nga data e konstituimit të saj ligjor deri në datën 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2050 (dy mijë e pesëdhjetë).

## **KAPITALI**

### **Neni 6 - Kapitali**

Kapitali aksionar është 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë / 00), i ndarë në aksione në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Neni 7 Transferimi i aksioneve**

7.1.1. Transferimet e aksioneve i nënshtrohen rregullores së mëposhtme, e cila synon të mbrojë interesat e shoqërisë, barazinë e strukturës aksionare, kohezionin e aksionarëve dhe ekuilibrin e marrëdhënieve ndërmjet tyre: prandaj vendosen si më poshtë. kufizimet në rastin e transferimit të aksioneve.



**7.1.2.** Me "pjesëmarrje" (ose "aksione") nënkuptohet kapitalin aksionar që i takon çdo aksionari ose pjesë e tij në rast të transferimit të pjesëshëm dhe/ose gjithashtu të drejtave e nënshkrimit që lidhen me të.

**7.1.3.** Me "transferim" nënkuptohet transferimi me akt mes të gjallë.

**7.1.4.** Termi "transferim me akt ndërmjet personave të gjallë" nënkupton përfshirjen e të gjitha transaksioneve të shitjes, në kuptimin më të gjerë të termit dhe për rrjedhojë, përveç shitjes, pe për shembull, kontratat e shkëmbimit, dhënies, pagese e dhëne, transferimit i mandatit fiduciar dhe dhurimi. Në të gjitha rastet kur natyra e marrëveshjes nuk parashikon një shumë ose kompensimi është i ndryshëm nga paratë, aksionarët do të blejnë pjesëmarrjen duke i paguar ofertuesit shumën e përcaktuar me marrëveshje të përbashkët ose, në mungesë të marrëveshjes, nga arbitruesi, siç specifikohet më së miri në këtë nen.

**7.1.5.** Në rast të një transferimi të kryer pa respektuar atë që përcaktohet më poshtë, blerësi nuk do të ketë të drejtë të ushtrojë votën dhe të drejta të tjera administrative dhe nuk do të jetë në gjendje të tjetërsojë aksionet me efekt ndaj shoqërisë.

**7.2.1.** Pronat janë të ndashme dhe të transferueshme lirisht vetëm në favor të :

a. aksionarëve të tjerë;

b. bashkëshorti i një aksioneri;

c. të afërmyve në linjë të drejtë të një aksionari, në çdo shkallë

d. të shoqërive mëmë, filialeve, bashkëpunëtorëve ose në çdo rasteve i përkasin të njëjtit grup shoqëriash partnere.

Në çdo rast tjetër të transferimit të aksioneve, i takon aksionereve, e drejta e parablerjes për blerjen.

**7.2.2.1.** Për këtë arsye, aksionari që synon të shesë ose në çdo rast të transferojë aksionet e tij duhet të njoftojë të gjithë aksionarët që rezultojnë në Regjistrin e Shoqërive me letër rekomande dërguar secilit prej tyre si rezultat i komunikimeve të bëra në bazë të nenit 4 me sipër; komunikimi duhet të përmbajë të dhënat e marrësit dhe kushtet e transferimit, duke përfshirë, në veçanti, çmimin dhe mënyrat e pagesës.

Aksionerët marrës i komunikimeve të mësipërme duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e aksioneve të cilës i referohet komunikimi duke i dërguar aksionerit ofertues deklaratën e ushtrimit të parablerjes me letër rekomande të dorëzuar në zyrën postare jo më vonë se 30 ditë nga data e dërgesës (që rezulton nga vula postare) e ofertës së parablerjes.

**7.2.2.2.** Në rastin e e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e më shumë se një aksionari, pjesëmarrja e ofruar do të takojë aksionereve të interesuar në përpjesëtim me vlerën nominale të aksioneve në pronësi të secilit prej tyre.

**7.2.2.3.** Nëse ndonjë nga personat që kanë të drejtën e parablerjes nuk është në gjendje ose nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta që i takon shtohet automatikisht dhe proporcionalisht në favor të atyre aksionarëve, të cilët, anasjelltas, synojnë ta përfitojnë atë dhe nuk e kanë hequr dorë shprehimisht më parë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes që u takon atyre.

**7.2.2.4.** Nëse në komunikim tregohet se blerësi një person që është tashmë aksionar, dhe atij i njihet e drejta të ushtrojë parablerjen së bashku me aksionarët e tjerë.

**7.2.3.** Komunikimi me synim për të transferuar aksionet e formuluar në mënyrën e treguar është e barabartë me propozim kontraktor në zbatim të nenit 1326 të Kodit Civil. Prandaj kontrata do të konsiderohet e lidhur kur kushdo që ka bëri që komunikimi të bëhet i vetëdijshëm pranimi i palës



tjetër. Që nga ai moment, aksionari transferues është i detyruar të bjerë dakord me të transferuarin për përsëritjen e transaksionit në një formë të përshtatshme për regjistrim në Regjistrin e Shoqërive, me pagesën e njëkohshme të çmimit siç tregohet në "denuntiatio".

**7.2.4.1.** Parablerja duhet të ushtrohet për çmimin e treguar nga ofertuesi.

**7.2.4.2.** Nëse çmimi i kërkuar konsiderohet i lartë nga ndonjë prej aksionarëve që ka shprehur vullnetin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes në kushtet dhe format e mësipërme ose nuk është rënë dakord për një çmim në para, çmimi i shitjes do të përcaktohet nga palët në marrëveshje mes tyre.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, palët do të mundësojnë emërimin e një Këshilli Arbitror të përbërë nga tre anëtarë. Aksionari ose aksionarët që synojnë të iniciojnë këtë procedurë arbitrazhit duhet të njoftojë aksionarin ofertues dhe aksionarët e tjerë me letër rekomande

dorëzuar në zyrën postare jo më vonë se 30 ditë nga data e dërgimi (që rezulton nga vula postare) e ofertës së parablerjes, duke siguruar në të njëjtën kohë për të komunikuar emërimin e arbitrit të tij. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të ardhshme pas marrjes së komunikimit të sipërpërmendur, aksionari ofertues do të duhet të caktojë arbitrin e tij, duke i komunikuar me aksionerin ose aksionarët të cilët nisen procedurën e arbitrazhit dhe, për dijeni dhe aksionereve të tjerë.

Anëtarët. Dy arbitrat e emëruar në këtë formë duhet të caktojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga emërimi i arbitrit të caktuar nga Aksionari ofertues, Arbitri i tretë, i cili do të jetë President i Këshillit. Në rast të mosmarrëveshjes për caktimin e Arbitrit të tretë, si dhe në rast mos caktimi nga ana e Aksionerit ofertues, Arbitri i dytë dhe/ose i tretë do të emërohen nga Kryetari i Gjykatës së Milanos me kërkesë të Aksionerit më i kërkuar. Po kështu, Kryetari i Gjykatës së

Milanos do të emërojë arbitrin e parë si pasojë e mungesës së marrëveshjes ndërmjet aksionarëve që kanë ushtruar të drejtat e refuzimit të parë, me kërkesë të Aksionerit më kërkuar.

**7.2.4.3.** Këshilli i Arbitrazhit do të duhet të japë përcaktimin e vet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga themelimi dhe duhet ta bazojë atë në një vlerësim, nëpërmjet një vlerësimi të drejtë gjendjen financiare të kompanisë, përfitimin e saj, si dhe çdo rrethanë dhe kushte që mbahet normalisht në konsideratë me qëllim të përcaktimit të vlerës së shoqërisë që operojnë në sektorë të ngjashëm. Këshilli do të komunikojë në të njëjtën kohë për të gjithë anëtarët vlerësimet e tyre sapo të jene gati. Çmimi i përcaktuar nga Këshilli do të jetë i detyrueshëm për palët. Megjithatë, aksionerët që kanë ushtruar të drejta e parablerjes do të ketë të drejtën e heqjes dorë blerja me çmimin e përcaktuar nga Këshilli duke e komunikuar me letër rekomande me njoftim marrje për aksionerin ofertues brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas komunikimit të Këshillit. Nëse të gjithë aksionarët që kanë të drejtë parablerjeje kanë hequr dorë nga blerja, shpenzimet e blerjes do të përballohen ekskluzivisht nga ata që heqin dorë dhe anëtari ofertues do të jetë i lirë të transferojë pjesëmarrjen e tij/saj sipas kushteve të treguara në ofertë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit të këshillit. Nëse ky transferim nuk ndodh brenda afatit të sipërpërmendur, aksionari ofertues do të duhet sërish të respektojë dispozitat e këtij neni.

**7.2.5.2.** Në rastet kur çmimi i vendosur nga Këshilli i Arbitrazhit është më i lartë se çmimi i ofruar nga blerësi potenciali, transferimi në favor të aksionarëve që kanë të drejtë parablerje në çdo rast do të bëhet me çmimin e ofruar nga blerësi potenciali; në rast se çmimi i caktuar nga arbitri do të rezultojë jo më shumë se 10% më e ulët se çmimi i ofruar nga blerësi potencial, transferimi në favor të aksionerëve që kanë të drejta e parablerjes do të bëhet me çmimin e përcaktuar nga arbitri.





Nëse çmimi i vendosur nga arbitri jo më shumë se 10% më e ulët i çmimit të ofruar nga blerësi potencial, aksionari që synon të procedojë me transferimin do të ketë të drejtë të heqë dorë nga ky qellim duke njoftuar organin administrativ me letër rekomande me dëftese kthimi, njoftim i cili gjithashtu do t'u përcillet të gjithë anëtarëve të cilët kanë ushtruar të drejtën e parablerjes, brenda afatit prej 30 nga marrja e vendimit të sipërpërmendur të arbitrit.

Nëse aksionari ofertues e përdor këtë opsion, si oferta ashtu dhe komunikimi i ushtrimit të drejtës së parablerjes do të jenë pa asnjë efekt. Aty ku aksionari ofertues nuk e shfrytëzon këtë të drejtë, transferimi në favor të aksionarëve që kanë të drejtën e parablerjes do të kryhet me çmimin e përcaktuar nga arbitri.

**7.2.5.4. Kostoja e arbitrit do të jete ne ngarkim te:**

a) të aksionarëve që kanë të drejtë parablerjeje dhe që kanë deklaruar të mos pranojnë çmimin, në raport me aksionet përkatëse, ne rastet kur çmimi i përcaktuar nga arbitri është jo më shumë se 10% më e ulët i çmimit të ofruar nga blerësi potencial;

b) të aksionerit ofertues, nëse është përcaktuar çmimi nga arbitri është më shumë se 10% më e ulët se çmimi i ofruar nga blerësi potencial dhe ai ka shfrytëzuar të drejtën e te hequrit dore.

c) gjysma e aksionarëve që kanë të drejtën e parablerjes dhe që që kanë deklaruar se nuk pranojnë çmimin, në përpjesëtim me aksionet përkatëse dhe gjysma e aksionereve ofertues,

nëse çmimi i përcaktuar nga arbitri është më e ulët se më shumë se 10% me çmimin e ofruar nga blerësi potencial por aksionari ofertues nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të hequr dorë.

**7.2.6.1. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për gjithë pjesëmarrësit e ofruar, pasi ky është objekt i propozimit i formuluar nga aksionari ofertues; ne rast se asnjë aksionar synon të marrë pjesëmarrjen e ofruar ose e drejta ushtrohet vetëm për një pjesë të saj, aksioneri ofertues do të jetë të lirë për të transferuar të gjithë aksionin te blerësi i përcaktuar në komunikimin brenda 60 ditëve nga dita e marrja e vete komunikimit nga ana e aksionereve.**

**7.2.6.2 Ne rast se parablerja nuk ushtrohet ne afatet e përcaktuara për te tere aksionet e ofertuara, aksioneri ofertues, kur nuk pranon ushtrimin e parablerjes duke u limituar ne një pjese te vete aksioneve do te jete i lire te transferojë te gjithë aksionet tek blerësi i përcaktuar ne komunikim brenda 60 ditëve nga data e marrjes se vete komunikimit nga ana e ortakeve, ose, nëse pranon ushtrimin e parablerjes nga një pjesë e pjesëmarrjes së ofruar, mundet brenda së njëjtës periudhë prej 60 ditësh për të transferuar atë pjesë të pjesëmarrjes tek aksionari që ka ushtruar të drejtën e parablerjes, sipas kushteve që do të bien dakord me vete atë.**

Nëse kalimi tek aksionari nuk ndodh brenda afatit më sipër treguar, aksionari ofertues do të duhet përsëri të pajtohet me dispozitat e këtij neni.

**7.2.7. E drejta e refuzimit të parë për aksionarët edhe kur synon të transferojë pjesën e zhveshur të aksioneve. E drejta e refuzimit të parë jo në rastin e pengut ose uzufuktit.**

**7.2.8. Në rastin e shitjes së përbashkët të aksioneve nga disa aksionarë, parablerja do të konsiderohet e ushtruar në mënyrë efektive vetëm nëse ka të bëjë me të gjitha aksionet në shitje.**

**7.3. Aksionet e transferuara me pasim legjitim ose testament duhet t'u ofrohet ne parablerje të gjithë aksionereve në mënyrën dhe me efektet e përmendura në nenin e mësipërm 7.1.**

Derisa të jetë bërë oferta dhe të rezultojë se kjo nuk është pranuar, trashëgimtari apo legatari nuk do të konsiderohet aksioner, nuk do të legjitimohet ne ushtrimin e votës dhe të të drejtave të tjera administrative ne lidhje me aksionet dhe nuk do të jetë në gjendje të tjetërsoje aksionet me efekt drejt shoqërinë.



## VENDIMET E AKSIONARËVE - MBLEDHJA E AKSIONARËVE

### **Neni 8 - Vendimet e aksionarëve**

8.1. Aksioneret vendosin për çështjet që u rezervohen kompetencave të tyre ligjore dhe nga ky statut, si dhe në argumentet që një ose më shumë administratore ose shumë aksionarë të cilët përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit, i nënshtrohen miratimit të tyre.

8.2. Vendimet e aksionarëve miratohen me vendim asambleje ose jo në formën e asamblesë.

8.3. Vendimet e aksionereve në formë asambleje ose jo, janë marre me votën në favor të më shumë se gjysmës së kapitalit themeltar të shoqërisë, përveç nëse kërkohet ndryshe me ligj.

### **Neni 9 - Vendimet në formë të pa mbledhur**

9.1. Miratimi i pasqyrave financiare dhe shpërndarja e fitimeve ose rezervat, emërimi ose revokimi i administratoreve, emërimi i një organ kontrolli dhe/ose një audituesi, përcaktimin e shpërblyerjeve përkatëse dhe në përgjithësi të gjitha vendimet e rezervuara për të aksionarët, por që me ligj apo statut nuk duhet të miratohen me vendim asambleje mund të merren me iniciativën e Administratorit të Vetëm, të Kryetarit të Keshillit të administrimit ose të më shumë aksionerëve që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksioner, nëpërmjet nënshkrimit nga ana e aksionereve, edhe në kohë të vende të ndryshme, të një ose më shumë të dokumenteve të njëjta në të cilat tregohet qartë argumenti objekti i këtij vendimi, afatin kohor të caktuar për shprehjen e pëlqimit, vete pëlqimin dhe datën në të cilën është dhënë.

9.2. Dokumentacioni i mësipërm ruhet në aktet e shoqërisë dhe në çdo rast transkriptohet pa vonesë në kujdesin e Administratorit të Vetëm ose Kryetarit të Keshillit të administrimit në librin e vendimeve të aksionerëve të mbajtur në përputhje me ligjin.

9.3. Procedura e përmendur në këtë nen nuk i nënshtrohet kufizime të veçanta me kusht që ato të jenë të siguruara për secilin aksioner informacion të barabartë dhe të drejtën për të marrë pjesë në vendim, dhe njoftohen të gjithë administratoret dhe organi i kontrollit, nëse emërohet.

Vendimi merret kur Drejtori i vetëm ose Kryetari i Bordit të Drejtorëve merr pëlqimin e shumë aksionarëve që përfaqësojnë shumicën e përmendur në nenin 8.3 më sipër dhe vendoset brenda afatit të caktuar.

9.4 Administratori i vetëm ose Kryetari i Keshillit të administrimit komunikojnë vendimin e procedurës të gjithë aksionereve, administratoreve dhe organit kontrollues nëse emërohet.

### **Neni 10- Vendimet e aksionereve në formë të mbledhur**

Duhet të merren në formë të mbledhur:

- vendimet në lidhje me ndryshimet në statutin e shoqërisë duke përfshirë bashkimet dhe shkrirjet (përveç, kur lejohet, kompetencave të organit administrativ në rastet e përmendura tek nenet 2505 dhe 2505 bis kod. civil., siç përmendet edhe nga neni 2506 trete i kodit civil);

-vendimet për kryerjen e veprimeve që sjellin një modifikim thelbësor i objektit të shoqërisë dhe një modifikimin i rëndësishëm i të drejtave të aksionarëve si dhe marrjen e aksioneve nga të cilat rrjedhin përgjegjësi të pakufizuara për detyrimet e shoqërive pjesëmarrëse;

- çdo vendim tjetër që është rreptësisht konfidencial nga ligji i asamblesë.



-vendimet në lidhje me shpërbërjen e parakohshme të shoqërinë, emërimin ose revokimin e likuiduesve dhe përcaktimi i kompetencave përkatëse;

- çdo përcaktim tjetër që ka të bëjë kompetencën e aksionereve për të cilët Administratori i Vetëm ose Kryetari ose një anëtar i Bordit Drejtues ose sa më shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën një e treta e kapitalit kërkojnë mbledhjen e asamblesë .

#### **Neni 11 - Mbledhja e asamblesë**

**11.1.** Asambleja thirret nga Administratori i Vetëm, nga Kryetari i Bordit Drejtues ose ata këshilltare të deleguara nga bordi për këtë qëllim, me letër te rekomanduar ose faks ose e-mail, për t'u dërguar në vendbanimin e aksionarëve, administratoreve dhe anëtarëve të organit kontrollues, nëse emërohet, jo më pak se 8 (tetë) ditë para mbledhjes ose me njoftim të dërguar dhe më pas, por për të cilën është vërtetuar prova e marrjes të paktën 5 (pesë) ditë para mbledhjes.

**11.2.** Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së shoqërisë, për aq kohë sa është në Itali.

**11.3.** Njoftimi i mbledhjes duhet të tregojë vendin, ditën, orën dhe axhendën e mbledhjes dhe mund të parashikojë dhe një mbledhje të dytë të mundshme, nëse në të parën nuk ndërhyr pala e kërkuar për të vendosur.

**11.4.** Sidoqoftë janë të vlefshme asambletë, edhe nëse nuk thirren në këtë mënyrë, nëse përfaqësohet i gjithë kapitali aksionar dhe të gjithë administratoret dhe anëtarët ose anëtarët e organit të kontrollit, nëse një i tillë emërohet, janë të pranishëm ose në çdo rast të informuar për mbledhjen dhe askush nuk e kundërshton diskutimin e pikave në rendi i ditës.

#### **Neni 12 - Pjesëmarrja në asamble**

**12.1.** Mund të marrin pjesë në asamble të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar si të tilla në Regjistrin e Shoqërive dhe që në rastin e blerjes së aksioneve, kanë vëzhguar procedurat e për vetë blerjen nga ky statut.

Vota e aksionarit është e vlefshme në raport me votën e tij të pjesëmarrjes.

**12.2.** Çdo aksionar mund të përfaqësohet në asamble me prokuror me shkrim dhe dokumentacioni përkatës dhe e ruajtur nga shoqërinë.

**12.3.** Ndërhyrja në asamble mund të bëhet përmes një lidhje audio/televizive në përputhje me parimet e nenit 16, paragrafi i katërt me kusht që të jepet lajmi në njoftimin e asamblesë.

**12.4.** I takon Kryetarit të bordit të konstatojë të drejtën për të marrë pjesë në takim.

#### **Neni 13 - Kryesimi i asamblesë dhe verbalizimi**

**13.1.** Asambleja kryesohet nga administratori i vetëm ose nga Kryetar këshillit të administrimit, ose në mungesë ose pengesë nga një person i zgjedhur nga kuvendi.

**13.2.** Vendimet e asamblesë konfirmohen nga verbali i nënshkruar nga kryetari dhe sekretarinë rastet e parashikuara nga ligji dhe kur Presidenti e konsideron të nevojshme, verbali është hartuar nga një Noter i zgjedhur prej tij.

### **ADMINISTRATA**

#### **Neni 14 - Përbërja e organit administrativ**

**14.1.** Menaxhimi i shoqërisë i është besuar një administratori të vetëm ose një Këshilli administrimi të përbërë nga një numër të ndryshueshëm nga 3 (tre) deri në 7 (shtatë) administratore sipas vendimeve të marra nga aksionarët në aktin e vendimit të emërimit .



14.2. Administratoret mund të jenë edhe jo aksionarë, zgjasin në detyrë për periudhën e caktuar në momentin e emërimit, janë të ri-emërueshëm të nënshtruar shkaqeve të papërshtatshmërisë, ose rënia e nenit. 2382 kod. civile, por jo atyre të parashikuara nga neni 2390 kodit civil përveç nëse vendoset ndryshe nga aksionarët.

14.3. Me vendim të aksionarëve, edhe gjatë mandatit të tyre, mund të ndryshojë numri i anëtarëve të këshillit të administrimit, gjithmonë brenda kufijve të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, duke parashikuar emërimet përkatëse. Administratoret kështu të zgjedhur skadojnë me ata në detyrë.

14.4. Nëse një ose më shumë administratorë nuk janë prezent për për çfarëdo arsye tjetër përveç fillimit të mandatit, zëvendësimi bëhet me vendim të aksionarëve.

Administratori i emëruar në këtë mënyrë skadon së bashku me të tjerët në detyrë në momentin e emërimit të tij.

14.5. Nëse gjatë ushtrimit të detyrës për shkak të dorëheqjes ose për shkaqe të tjera mungon gjysma, në rast numri të barabartë, ose më shumë se gjysma, në rast numri tek, e administratoreve në detyrë, i gjithë Këshilli konsiderohet se ka retë i gjithë Këshilli me efekt nga momenti i rikostituimit të tij, dhe të administratoreve e mbetur në fuqi duhet t'i kërkojnë aksionereve emërimin e Këshillit të ri të administrimit.

#### **Neni 15 - Kompetencat e Këshillit të administrimit**

15.1. Këshilli i administrimit është janë dhëne kompetencat më të gjera për drejtimin e shoqërisë, me të drejtë për të kryer të gjitha aktet, duke përfshirë dispozitat, të cilat ajo i sheh të përshtatshme Përbashkësitë ato për të cilat ligji i rezervon në rruge ekskluzive asamblesë ose në çdo rast me vendim të aksionarëve.

15.2. Këshilli i administrimit, atje ku nuk kanë parashikuar aksionerët, emëron nga radhët e anëtarëve të tij një President dhe një zëvendës president.

15.3. Këshilli i administrimit mund të delegojë, brenda kufijve të nenit 2381 të kodit civil sa zbatohet dhe brenda kufijve të statutit, funksionet e duhura Presidentit dhe një ose më shumë prej anëtarët të tij.

15.4. Këshilli i administrimit mund të vendose, në forma dhe brenda kufijve ligjor, bashkimin dhe ndarjen në hipotezat e neneve 2505, 2505 bis, siç përmendet edhe nga neni 2506 trete i Kodit Civil. Mund të emërojë edhe drejtore dhe të përgjithshëm si dhe përfaqësues për akte ose kategori aktesh të veçanta.

#### **Neni 16 - Thirrja, mbledhjet dhe vendimet e Këshillit të Administrimit**

16.1. Këshilli i Administrimit thirret nga Presidenti sa herë që e sheh të nevojshme me komunikim me shkrim edhe me faks, telegram ose e-mail që duhet të merret të paktën tre orë para mbledhjes. Në rast urgjence, Këshilli mund të mbledhet edhe me lidhje telefonike, me një lajmërim të paktën dymbëdhjetë orë përpara. Presidenti ka detyrimin të telefonojë menjëherë Këshillin e Administrimit kur bën kërkesë me shkrim të paktën njëzet për qind e Këshilltareve në detyrë ose organi i kontrollit, nëse emërohet.

16.2. Thërritja duhet të përmbajë të paktën ditën, vendin dhe orën në të cilën do të mbahet mbledhja dhe rendin e ditës.

16.3. Këshilli i Administrimit është i formuar në mënyrë të vlefshme dhe në mungesë të një thirrjeje formale, të jenë prezent të gjithë ose shumica e anëtarëve të organeve të administrimit



dhe kontrollit, nëse ky i fundit është emëruar, dhe ata që mungojnë, të informuar për mbledhjen, nuk janë kundër diskutimit të pikave të rendit të ditës.

**16.4** Mbledhjet e Keshillit të administrimit dhe, nëse emëruar, të Keshillit të Audituesve Ligjorë, ato mund të kryhen edhe me telekonferencë ose videokonferencë me kusht që të gjithë pjesëmarrësit mund të identifikohen, tu lejohet të ndjekin diskutimet dhe të ndërhyjnë në kohe reale në trajtimin e argumenteve të trajtuara dhe të informohen në mënyre të barabartë; kur plotësohen këto kërkesa, Këshilli i administrimit dhe mbledhjet e Bordit të Audituesve Ligjorë, konsiderohen të mbajtura në vendin e treguar në njoftimin e thirrjes.

**16.5** Me iniciativë të Presidentit, për tu komunikuar, me dokumentacionin përkatës, dhe organin mbikëqyrës, nëse është emëruar, vendimet e Keshillit mund të merren gjithashtu, në bazë të nenit. 2475 të kodit civil nëpërmjet nënshkrimit nga ana e administratorëve edhe në vendet e ne kohë të ndryshme të një ose më shumë dokumenteve identike nga të cilat rezultojnë qartësisht argumenti objekt i vendimit, pëlqimi i tij dhe data në të cilën është dhënë. Dokumentacioni i mësipërm ruhet në aktet e shoqërisë dhe është transkriptuar në librin e të vendimeve të administratorëve, të mbajtura në përputhje me ligjin.

Të gjithë administratorët duhet të jenë të autorizuar që të marrin pjesë me informacion të barabartë në procesin e vendimmarrjes që duhet të plotësohet brenda afatit kohor të përcaktuar nga Presidenti.

Vendimi merret kur merr pjesë dhe njoftohet Presidenti i keshillit të administrimit, brenda afatit të parashikuar, me pëlqimin e shumicës së anëtarëve të saj në detyrë.

Presidenti i i Keshillit të Administrimit njofton rezultatit të procedurës të gjithë administratorëve dhe, nëse është emëruar, organit të kontrollit.

**16.6** Përgatitja e projektbuxhetit dhe projekteve të bashkimi dhe ndarjes, vendimet e bashkimit ose ndarjes ndër të cilat në nenet 2505, 2505 bis, siç përmendet edhe nga neni 2506 treta i kodit civil, janë të rezervuara për kompetencën kolegjiale të Keshillit të administrimit, pa të drejtë delegimi, megjithatë, gjithmonë pa paragjykuar mundësinë që takimi të zhvillohet me audio ose telekonferencë.

**16.7** Për vlefshmërinë e vendimeve të keshillit të administrimit është e nevojshme prania e shumicës së administratorëve në detyrë dhe votën e favorshme të mazhorancës të të pranishmëve duke përjashtuar nga përlogaritja administratorët që abstenojnë për shkak të konfliktit të interesit.

#### **Neni 17 - Kompetencat e Administratorit të Vetëm**

**17.1** Administratori i vetëm ka të gjitha kompetencat e administrimit të shoqërisë që ky statut i atribuon Bordit të Drejtorëve dhe kompetencat e përfaqësimit që i atribuohen Kryetarit të Keshillit të Administrimit.

**17.2** Për kryerjen e akteve të mëposhtme, të konsideruara në çdo rast se tejkalojnë administrimin e zakonshëm të shoqërisë:

- blerjen, shitjen, uzufuktin dhe dhënie me qira të shoqërive dhe të pasurive të paluajtshme;
- vendosja e të drejtave reale duke përfshirë garancitë e pasurive të paluajtshme;
- dhënie me qira të kompanive dhe pasurive të paluajtshme për më shumë se nëntë vjet;
- blerja dhe shitja e aksioneve të shoqërisë;
- dhënie të garancive reale dhe personale;
- nënshkrimi i marrëveshjeve të kredisë afatmesme dhe afatgjata;



- themelimi i shoqërive;
- tjetërsimi i aseteve për shuma unike mbi 50,000,00 €
- nënshkrimi, modifikimi, përfundimi i marrëveshjeve dhe kontratave ndërmjet shoqërive dhe aksionarët ose shoqëritë mëmë, filialet e të kontrolluara nga kompanitë mëmë dhe filialet, administratori i vetëm duhet të marrë miratimin paraprak nga aksionarët.

#### **Neni 18- Përfaqësimi i shoqërisë**

18.1 Administratorit të vetëm, Presidentit të Keshillit të Administrimit dhe brenda kufijve të kompetencave të dhëna, Keshilltareve të deleguar i takon, me firme të lire përfaqësimi ligjor i shoqërisë përpara palëve të treta dhe në gjykim, me të drejtën për të nxitur veprimet dhe kërkesat gjyqësore administrative për çdo shikallë gjykimi e emërimi për këtë qëllim avokatët dhe përfaqësues.

18.2. Në rast të pengesës së Presidentit, të gjitha kompetencat e dhëna i takojnë Zv Presidentit, për palët e treta, në çdo rast, nënshkrimi i Zëvendës Presidentit është provë e plotë e pengimit ose mungesës së Presidentit.

18.3. Anëtarët e Keshillit të Administrimit edhe nëse nuk posedojnë prokurë të përhershme, kanë firmën e shoqërisë dhe përfaqësojnë shoqërinë përballë palëve të treta për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Keshillit i Administrimit për të cilat ata janë caktuar në mënyrë specifike.

18.4. Përfaqësimi i shoqërisë për veprime individuale ose kategoritë e akteve mund t'u jepen punonjësve të shoqërisë dhe palëve të treta nga personat që kanë të drejtë të ushtrojnë përfaqësimin ligjor.

#### **Neni 19 - Kompensimet**

19.1. Administratoreve i takon dhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsye të detyrës së tyre.

19.2. Kompensimet takuese të Administratoreve përcaktohen me vendim të aksionarëve.

Ata gjithashtu mund të përcaktojnë shumën totale për shpërblimi i të gjithë administratoreve duke përfshirë edhe ata me detyra të veçanta. Në këtë rast, këshilli i administrimit përcakton shpërndarjen e shpërblimit të ngarkuar me detyra të veçanta pasi ka dëgjuar mendimin e organit mbikëqyrës, nëse është emëruar.

19.3. Nëse aksionarët nuk e kanë bërë këtë sipas pikës më sipër, shpërblimi i administratoreve të ngarkuar me detyra të veçanta vendoset nga Këshilli i Administrimit pasi ka dëgjuar mendimin e organit mbikëqyrës, nëse është emëruar.

### **ORGAN MBIKËQYRËS DHE AUDITIMI LIGJOR I LLOGARIVE**

#### **Neni 20 -Organi i kontrollit dhe auditimi ligjor**

Emërimi i organit të kontrollit dhe/ose auditorit ligjor për llogaritë e kompanisë, kompetencat e tyre dhe përgjegjësitë përkatëse, janë të rregulluara nga neni 2477 i kodit civil dhe nga dispozitat e përfshira në kreun IV të Dekretit Legjislativ n. 39/2010.

Funksionet e kontrollit dhe/ose auditimit, me vendim të aksionarëve, mund t'i besohen, në vend të një organi të vetëm, në një organ kolegji (bordi i audituesve ligjorë), për përbërjen dhe funksionimin e të cilit zbatohen rregullat e përcaktuara për subjektin e shoqërive aksionare.



## BILANCI

### **Neni 21 - Viti financiar**

21.1. Viti financiar përfundon më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

21.2. Pasqyrat financiare u paraqiten aksionarëve brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga fundi i vitit financiar ose, nëse plotësohen kushtet ligjore, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga vetë fundi i vitit.

Administratoret raportojnë në relacion mbi menaxhimin dhe arsyet e shtyrjes .

### **Neni 22 - Shpërndarja e fitimeve**

Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare do të shpërndahen tek aksionarët në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapital sigurimet shoqërore, brenda kufijve të lejuar nga ligji e përveç nëse përcaktohet ndryshe nga vetë aksionarët.

## SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

### **Neni 23 - Shpërbërja dhe likuidimi**

Asambleja, në rast shpërbërjeje të shoqërisë, përcakton procedurat e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencave të tyre.

## REFERENCA LIGJORE

### **Neni 24 - Referenca ligjore**

Edhe pse nuk rregullohet shprehimisht në këtë statut, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.

## KLAUZA E ARBITRAZHIT

### **Neni 25 - Klauzola e arbitrazhit**

25.1. Çdo mosmarrëveshje duhet të lindë ndërmjet aksionarëve ose ndërmjet aksionarëve dhe shoqërisë që ka ne objekt të drejta të disponueshme në lidhje me raportin e shoqërisë , me përjashtim të atyre në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të ministrit publik , duhet të zgjidhet nga një arbitër i emëruar nga Kryetari i Dhomës Arbitrare të Milano, i cili duhet të bëjë takimin brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa e bërë nga ana me e kujdesshme. Në rast se personi i caktuar nuk e kryen funksionin brenda afatit, do të kërkohet takimi, nga pala më e kujdesshme, tek Kryetari i Gjykatës i vendit ku ndodhet kompania. Selia e arbitrazhit do të jetë në vendbanimi i arbitrit.

25.2. Arbitri duhet të vendosë brenda njëqind e njëzet ditësh nga data e emërimit. Arbitri do të vendosë mbi një bazë irracionale sipas barazisë.

Është vendosur në mënyrë të pakthyeshme që tani që rezolutat dhe vendimet e arbitrit do të obligojnë palët. Shpenzimet arbitrazhi do të jepen në ngarkim të palës humbëse, përveç rasteve të vendim të ndryshëm të arbitrit.

25.3. Arbitri i takojnë dhe mosmarrëveshjet në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve të aksionarëve; në këtë rast arbitri do të gjykojë sipas ligjit dhe mund të urdhërojë, edhe me Urdhëresa e pa thirrshme, pezullimi i efektivitetit të mendon vetë.

25.4. Në varësi të deklarimeve përkatëse të pranimit të detyrës, i nënshtrohen rregulloreve të mësipërme edhe mosmarrëveshjet e ngritura nga administratoret, likuiduesit dhe auditorët ligjorë



ose të ngritur në detyrë kundër tyre, të cilat kanë si objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhënien e shoqërisë .

**25.5.** Për sa nuk është parashikuar, aplikohen dispozitat e dekretit legjislativ n. 5 date 17 janar 2003,

**25.6.** Shuarja e kësaj klauzole arbitrazhi duhet të miratohet me vendim të mbledhjes së aksionarëve me një shumicë prej të paktën dy të tretave të kapitalit aksioner. Ndryshimet në përmbajtjen e kësaj klauzole të arbitrazhit duhet të miratohen me vendim të aksionarëve me shumicën e kërkuar për ndryshimet statutore.”

Nënshkruar Antonello Bonuglia

Nënshkruar Paolino Manfredi

Është kopje ne njëjtë me origjinalin ne aktet e mia.

Milano më 29 Nëntor 2013

Firma , vula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER VALBONA P. SINANI



V2022051460323826106

DATE 19/09/2022  
NR REP 3762



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 19/09/2022, para meje Notere VALBONA P. SINANI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.2, GEORGE W. BUSH, PALL "ALBSIG", NR.1, NR.12, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

**Edlira Shkokota**, atësia Pandeli, amësia Sadete, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në adresë E Saraçëve; Tiranë, lindur më 05/09/1975, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038149810 dhe nr. personal H55905042D.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur, nga gjuha **Italiane** në gjuhën **Shqipe** dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë;" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

VALBONA P. SINANI

